



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
- KRYEMINISTRI -

**Letër mandati për ministren e Punës dhe Politikës Sociale**

3 shtator, viti 2020

E nderuar ministre Shahpaska,

Në zgjedhjet parlamentare që janë mbajtur më 15 korrik të vitit 2020, qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut zgjedhën që të vazhdojmë ta dërgojmë shtetin përpara. Vota e qytetarëve për koalicionin që ka formuar Qeverinë e re me mandat prej vitit 2020 deri në vitin 2024 është investimi i tyre vetanak në kërkim të jetës më të mirë për vete, për familjet dhe bashkësinë e tyre. Vota e secilit qytetar është votë për mbrojtje nga KOVID-19 dhe për menaxhim të suksesshëm me krizën ekonomike-shëndetësore, votë për ekonominë e re vendore, për vende të reja të punës të paguara mirë, për shtet të së drejtës, për mjedis jetësor të pastër dhe të shëndetshëm, për infrastrukturë funksionale, për lidhje efektive brenda vendit dhe me botën, për kulturë të fuqishme nacionale sipas modelit evropian dhe arsim që i përgatit gjeneratat e reja për të tashmen dhe një të ardhme më të mirë.

Në kuptimin burimor të fjalës “ministër“ gjendet shërbimi, kujdesi dhe ndihma për qytetarët. Ju, si ministre, duhet ta kuptoni votën e qytetarit si drejtim i precizuar që vjen nga niveli më i lartë nga i cili nuk ka asnjë devijim. Duhet t’u shërbeni të gjithë qytetarëve, pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, partiake, orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor, racor, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë në grupe të marginalizuara, gjuhës, statusit social, shkollimit, religjionit, bindjet politike, bindjet tjera, aftësive të kufizuara, moshës, statusit familjar apo martesor, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, statusit personal dhe statusit shoqëror. Pres që për kryerjen e detyrave tuaja dhe në realizimin e Programit për punë të Qeverisë për vitet 2020-2024, do të angazhoheni pa hezitim dhe me profesionalizëm. Kemi detyrim të shenjtë dhe thelbësor që agjendën për të cilën obligohemi para qytetarëve ta realizojmë duke investuar përpjekjet tona maksimale, përmes realizimit efektiv për arritje të rezultateve më të mira të mundshme. Kjo mënyrë nuk njeh kompromise, justifikime dhe përfshin ekspozim të vazhdueshëm para opinionit publik ku do t’i vëmë në dispozicion të gjithë mekanizmat për të ndjekur punën tonë.

Ju jeni pjesë e Qeverisë e cila hapur e prezanton punën e saj dhe është e hapur për secilin qytetar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Unë, si Kryetar i Qeverisë do ta avancoj strukturën e kabinetit tim me qëllim që të jem Kryeministër më i hapur dhe të siguroj komunikim të dyanshëm me të gjithë qytetarët dhe bashkësitë të cilëve ju duhet ndihmë nga unë dhe shërbimet e mia, por edhe të kem mundësi që t’i pranoj dhe t’i kuptoj të gjitha idetë dhe iniciativat që vijnë nga opinionit publik. Ju obligoj edhe juve për komunikim të rregullt dhe të hapur me të gjithë qytetarët dhe palët e interesit në shoqëri duke avancuar kanalet për përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje dhe pjesëmarrje.

Puna e juaj çdo ditë do të ndiqet dhe matet. Nëse jeni të përkushtuar, të ndershëm dhe të përgjegjshëm do të keni rezultate të shkëlqyeshme dhe do të vazhdoni të punoni edhe më mirë për më shumë rezultate. Në të kundërtën, do të zëvendësoheni me kuadër tjetër i cili është i gatshëm të jep angazhim më të mirë dhe më të sigurtë se sa Ju. Vetëm kështu është e drejtë



## Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut - KRYEMINISTRI -

dhe e ndershme para fjalës që ua kemi dhënë qytetarëve. Për atë, konkluzionet e para nga puna juaj do t'i sjell pas përfundimit të 100 ditëve të para të mandatit, gjegjësisht në përfundim të vitit 2020, pas të cilit janë të mundshme ndryshime kadrovike. Analizën metodologjike të realizimit të detyrave dhe punës suaj të përgjithshme do ta bëjmë çdo fundvit.

Duke ju nominuar juve për ministre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, isha i bindur se mund të llogaris në përgjegjësinë dhe përkushtimin tuaj të plotë në kryerjen e detyrave. Pikërisht për këtë, pres rezultate të menjëhershme. Qytetarët kanë pritje, ndërsa Ju jeni në pozicion që të bëni gjithçka që është e nevojshme që Qeveria të realizojë pritjet e qytetarëve.

Një prej përcaktimeve kyçe të kësaj Qeverie është kujdesi për të gjithë. Investimet sociale i shohim edhe si mënyrë për të mbështetur njerëzit që të mund të ballafaqohen me rreziqet jetësore. Ky investim është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës. Politika e Qeverisë në këtë mandat do të vazhdojë paralelisht të ulë papunësinë dhe të stimulojë rritje të pagave, të mundësojë kushte më të mira për të rinjtë dhe ta avancojë barazinë gjinore.

Si Qeveri vendosëm qëllime serioze në këtë sferë dhe mu për këtë, si ministre e Punës dhe Politikës Sociale, në mandatin Tuaj pres që të krijoni dhe të nxisni politika bazuar në argumente dhe eupati, duke larguar barrierat dhe stereotipet.

Më konkretisht, nga Ju pres:

- Të zbatoni masa të cilat do ta ulin papunësinë për 3% në nivel vjetor, gjatë të cilit së bashku çdo vit do të sigurojmë 2 miliardë denarë për masat aktive për mbështetje të punësimit dhe vetëpunësimit;
- Të krijoni politika për përmirësimin e kushteve të punonjësve sezonal, përfshirë edhe vendosjen e sistemit me vauçer, për të paguar kontributet sociale për punonjësit sezonal;
- Në mënyrë aktive dhe me përkushtim të zbatoni masa për uljen e varfërisë për të njëjtën të arrihet shkalla më e vogël se 16% me theks në varfërinë e fëmijëve;
- Të punoni në përmirësimin dhe digjitalizimin e shërbimeve sociale për qytetarët;
- Të vendosni koncept “Komuna kujdeset” përmes së cilit do të krijohen kushte të reja për qytetarët, por edhe vende pune në këtë sektor, ndërsa do të mundësohet edhe hapje e zyrave të qendrave për punë sociale në çdo komunë në territorin e shtetit;
- Ta ratifikojmë Marrëveshjen nga Marakeshi në drejtim të realizimit të të drejtave për personat me aftësi të kufizuara. Paralelisht, të përgatisni dhe deri te Qeveria të prpozoni Ligj të ri për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, vendosje të rehabilitimit profesional të paguar nga shteti në vitin 2021 dhe përpunim të Regjistrimit nacional të personave me aftësi të kufizuara;
  - Të hapni Qendër për fëmijë/persona më të rritur me autizëm në Shkup;
  - Të vendosni Qendër për zëvendësimin e kujdesit familjar në shtet;
- Kujdesi për familjen të mbetet lartë në agjendë:
  - Në bashkëpunim me Qeverinë të vendosni Fond shtetëror për pagesën e qëndrimit ligjor të fëmijëve në situata kur njëri prind pas divorcit nuk i plotëson obligimet ligjore;



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
- KRYEMINISTRI -

- Të siguron i së paku 7.500 vende për fëmijët në kopshte, ndërsa për të gjithë fëmijët nga familje me të ardhura të ulëta, bashkërisht të sigurojmë kujdes falas;
- Shtesën për kujdes familjar në familje për kujdes ta rrisim për 30%;
- Gradualisht të krijoni politika për përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave të moshuar dhe sigurim i pleqërisë dinjitoze:
  - Të krijoni sistem stabil pensional për pensionistët e tashëm dhe të ardhshëm – sistem fleksibil pensional me sjelljen e mundësisë për pensionim të parakohshëm deri në maksimum 5 vite para realizimit të së drejtës së pensionit, me shumë proporcionalisht të ulur të pensionit të rregullt dhe të mundësoni bazë ligjore për blerje të stazhit me qëllim marrjen e së drejtës së pensionit;
  - Ta rrisni pensionin minimal që të jetë së paku 10.700 denarë për të gjithë;
  - Të kontribuoni në përforsimin e rolit të personave të moshuar në jetën publike, përmes hapjen e mundësive për vullnetarë dhe angazhimit të punës së personave të moshuar që duan ta bëjnë atë;
  - Të vendosni 10 qendra për plakje aktive dhe të shëndetshme të personave të moshuar;
- Të zbatoni masa që i përfshijnë të rinjtë dhe të ardhmen e tyre, veçanërisht në drejtim të rritjes së punësimit të tyre:
  - Të vazhdojë pagesa e 3.000 denarë në muaj shtesë për të rinjtë për t[ rinjtë e punësuar deri në moshën 23 vjeçare që së paku e kanë përfunduar shkollimin e mesëm dhe të cilët punojnë në prodhimtari;
  - Në bashkëpunim me institucionet kompetente të mundësojnë rimbursimin e tatimit personal për të gjithë të punësuarit e ri nën moshën 30 vjeçare, si dhe lirim nga pagesa e tatimit të të gjithë ndërmarrjeve të sapokrijuara private, të formuara prej të rinjve deri në moshën 30 vjeçare dhe grave, deri sa përfitimi është nën 3 milionë denarë;
  - Mbështetje e drejtpërdrejtë për sipërmarrjen e të rinjve dhe grave përmes granteve në vlerë prej 5,000 deri 15,000 euro për fillimin e biznesit të tyre dhe të ri;
  - Të përgatisni dhe deri te Qeveria të propozoni Ligj për garanci për të rinjtë;
  - Të përgatisni dhe deri te Qeveria të rekomandoni Ligj për mbështetje të sipërmarrjes sociale, me fokus te të rinjtë dhe te gratë dhe me hapjen e tre qendrave për mbështetje të ndërmarrjeve sociale;
  - Të nxisni bashkëpunim të quajtur trille helix, gjatë të cilës universitetet, komuniteti i biznesit dhe Qeveria së bashku ti përgatisni programet mësimore që do të jenë përgjigje e vërtetë për nevojat dhe kërkesat e tregut të punës;
- Së bashku me Qeverinë dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale të krijoni politika për arritjen e barazisë gjinore, zbutjen e stereotipeve gjinore dhe eliminimi i dhunës bazuar në gjini:
  - Të punoni në harmonizimin e tërësishëm të rregullores ligjore për përmbushjen e standardeve në përputhje me Konventën e Stambollit;
  - Të krijoni politika dhe masa për punësim që do të ndikojnë në uljen e pasivitetit të gratë në tregun e punës, politika që do ta rregullojnë mungesën e prindit, mbrojtja në vendin e punës, orari fleksibil i punës dhe koha e shkurtuar e punës në vendet e punës që janë të përshtatshme për nënat, rritja e qasshmërisë së



## Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut - KRYEMINISTRI -

- kopshteve veçanërisht në ambientet rurale dhe rritja e numrit të shtëpive për persona të moshuar në të gjitha rajonet e planifikimit;
- Të përgatisni dhe deri te Qeveria të propozoni dispozita në Ligjin e raporteve të punës ku do të definohet pushimi i lehonisë, pushimi i atësisë, si dhe pushimi i përbashkët fleksibil i të dy prindërve;
  - Të përgatisni dhe të sillni Program për ri-integrimin e grave viktime të dhunës;
  - Të zbatoni edhe aktivitete tjera në përputhje me angazhimet dhe Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020-2024.

Njëkohësisht, si ministre e Punës dhe Politikës Sociale në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Ju pres:

- Të jeni gardiani i parë i Kushtetutës dhe ligjeve dhe të siguroni që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të përmbush të gjitha detyrimet ligjore, që të gjithë bartësit e funksioneve publike dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj të jenë njësoj të përgjegjshëm ndaj ligjit dhe Kushtetutës dhe se Kushtetuta dhe ligjet do të zbatohen njëjtë për të gjithë;
- Të jeni shembull i qeverisjes së mirë dhe të siguroni që zyrtarët publik dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj t'u përmbahen standardeve më të larta të qeverisjes së përgjegjshme dhe etike;
- Të siguroni që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të përgjigjet në kohë, në mënyrë të drejtë, efikase dhe efektive të zgjidh çështjet dhe procedurat e qytetarëve dhe personave juridik, duke justifikuar dhe fituar besimin e qytetarëve dhe të opinionit publik;
- Të vazhdoni zbatimin dhe përmirësimin e politikave të transparencës dhe llogaridhënies;
- Të jeni e hapur dhe gjithëpërfshirës ndaj qytetarëve, publikut profesional, shoqërisë civile dhe opozitës në krijimin dhe zbatimin e politikave publike në mënyrë që të siguroni politika cilësore të bazuara në prova dhe konsensus të shoqërisë;
- Të siguroni që burimet shtetërore të mos përdoren për qëllime partiake dhe zgjedhore dhe që zyrtarët administrativ dhe punonjësit e sektorit publik të mos jenë subjekt i ndikimit partiak;
- Të promovoni barazinë gjinore dhe përfaqësimin e drejtë dhe të keni parasysh karakterin multietnik të vendit.

Bashkëpunoni me të gjithë punonjësit dhe përdorni të gjitha potencialet e administratës publike. Në të gjitha veprimet tuaja, të jeni shembull për ata me të cilët punoni dhe për qytetarët për të cilët punoni. Respektoni Kodin etik për anëtarët e Qeverisë dhe mbajtësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria dhe promovoni vlerat etike. Në fund të mandatit tonë në vitin 2024, si rezultat i ndryshimeve pozitive që ne do të bëjmë, Maqedonia e Veriut të jetë vend ku qytetarët duan të jetojnë dhe të kontribuojnë në përmirësimin e saj të vazhdueshëm. Qytetarët e presin këtë nga ne.



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
- KRYEMINISTRI -

Ju uroj fat, shëndet dhe mandat të suksesshëm.

Sinqerisht i juaji,

Zoran Zaev

Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut